

TESTIMONY OF THE WITNESS AS EVIDENCE IN CRIMINAL PROCEEDINGS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Besjan Pollozhani

South East European University, Republic of N. Macedonia, bp22993@seeu.edu.mk

Abstract: The subject of research for this paper is the testimony of the witness as an evidence in criminal procedure in the Republic of North Macedonia, as well as from the comparative aspect, starting from the its historical aspect and until the modern law, respectively analyzing the overall aspects that are related to the testimony of the witness, such as: notions of testimony and the witness, the criteria that are needed to be represented in the quality of a witness, individuals that can be represented in the quality of a witness, individual that cannot be represented in the quality of a witness, the rights of the witness during interrogation, the procedure of questioning the witness, types of witnesses, the duty of the witness to testimony, the psychological aspect in the process witnessing as well as in other aspects.

The testimony of the witness represents one of the evidences that requires analyzes and study in depth. In our country, we can find studies and analyses on this issue also in other scientific researches, but the same has not been analyzed from the comparative aspect. The importance of this paper is expressed because it addresses one of the key aspects of criminal procedure law, which means the testimony of the witness in the criminal process in order to achieve a clearer and more accurate picture of the case.

Keywords: witness, testimony, evidence, Law on criminal procedure, comparative aspect

DËSHMIA E DËSHMITARIT SI PROVË NË PROCEDURË PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Besjan Pollozhani

Universiteti I Evropës JugLindore, Maqedonia e Veriut, bp22993@seeu.edu.mk

Abstrakt: Lëndë e hulumtimit të këtij punimi është dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe nga aspekti krahasues, duke filluar që nga aspekti historik i saj e deri tek e drejta pozitive ose bashkëkohore, gjegjësisht analizimi i aspekteve të përgjithshme që lidhen me dëshminë e dëshmitarit, siç janë: nocionet e dëshmisë dhe dëshmitarit, kushtet që duhet të plotësohen për t'u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, personat që mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, personat që nuk mund të paraqiten në cilësinë e dëshmitarit, të drejtat e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje, procedura e pyetjes së dëshmitarit, llojet e dëshmitarëve, obligimi i dëshmitarit për të dëshmuar, aspekti psikologjik në procesin e të dëshmuarit si dhe aspekte të tjera.

Dëshmia e dëshmitarit paraqet një nga provat që kërkon analizë dhe studime të thella. Në vendin tonë studime dhe analiza mbi këtë çështje hasim edhe nga hulumtime të tjera shkencore, mirëpo e njëjta nuk është analizuar edhe nga aspekti krahasues. Rëndësia e këtij punimi vjen në shprehje, ngaqë trajton një ndër aspektet kyçe të së drejtës së procedurës penale, që nënkupton dëshminë e dëshmitarit në procesin penal për të arritur një pasqyrë më të qartë dhe më të saktë mbi rastin e caktuar.

Fjalët kyçe: dëshmitari, dëshmia, provë, e drejta e procedurës penale, aspekti komparativ.

1. HYRJE

Kriminaliteti si fenomen i ndërlikuar ka ekzistuar prej në të kaluarën dhe ende vazhdon të shfaqet në përmasa edhe më të mëdha. Format e shfaqjes dhe manifestimit të tij gjatë tërë rrjedhës së historisë njerëzore janë nga më të ndryshmet. Edhe pse ekziston një numër i madh i dispozitave juridike të cilat janë të inkorporuara në legjislacionet penale për ndëshkimin e veprimeve të kundërligjshme, ato përsëri shfaqen dhe në vazhdimsi po ndërmerren veprime kriminale në shoqëri, ku për këtë arsye angazhimi i organeve kompetente për parandalimin e kriminalitetit si dhe risocializimin e kryerësve të atyre krimeve, paraqitet si synim kryesor.

Dëshmia e dëshmitarit si provë e rëndësishme në procedurë penale ka ekzistuar që në të kaluarën, pra ajo është përdorur që në fazat e para të reagimit shoqëror për ndriçimin e të gjithë çështjeve konkrete penale dhe zbulimin e kryerësve të atyre veprimeve kriminale dhe vazhdon të jetë evidente dhe prezente edhe në procedurat penale bashkëkohore.

Duke u bazuar në aspektin historik, mënyrat e marrjes dhe shqyrtimit të dëshmisë së dëshmitarit në procesin e të provuarit, kanë pësuar ndryshime thelbësore duke u inkorporuar metoda më humane me të cilat garantohej respektimi i lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të parapara edhe si kategori kushtetuese.

Dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale paraqet një nga provat më të rëndësishme gjatë procesit të të provuarit e cila ka ndikim direkt në zbardhjen e çështjes penale konkrete. Rëndësia e saj vërehet në atë se në praktikën e Gjykatësve dhe Prokurorëve ka pasur raste të cilat në të cilat çështja penale konkrete ka marrë formë të prerë duke marrë parasysh edhe dëshminë e dëshmitarit të dhënë, gjë të cilën e kam konfirmuar edhe me intervistat e realizuara me Gjykatës dhe Prokuror në Gjykatën Themelore në Strugë si dhe në Prokurorinë Publike në Strugë.

Në të gjithë procedurën penale, Gjykatësi gjatë shushitjes së provave i jep rëndësi të veçantë dëshmisë së një ose më shumë dëshmitarëve, e sidomos dëshmitarëve okular pasiqë ato janë persona që drejtpërsëdrejti e kanë perceptuar rastin konkret, pra të gjithë ndodhinë.

2. MATERIALI DHE METODAT

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë. Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme.

Materialet dhe literatura e përdorur për këtë punim kanë për qëllim të nxjerrin në pah rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit e cila ka një ndikim të madh në zbardhjen e plotë të një rasti të caktuar dhe marrjen e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe objektivë.

Metodat kryesore që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave janë:

1. Leximi i literaturës së përshtatshme për këtë çështje, e sidomos asaj juridike
2. Intervistimi
3. Të dhëna nga interneti;

Gjatë këtij punimi kam përdorur këto metoda:

1. Metodën dogmatike juridike,
2. Metodën empirike apo historike.

3. REZULTATI

Sëpari, nga ky punim përcaktohet rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale ku në raste të caktuara konsiderohet edhe si mbretëreshë e provave.

Konsiderohet mbretëreshë e provave sidomos në rastet kur nuk ekzistojnë prova të tjera në procedurë penale dhe si provë e vetme dhe e rëndësishme paraqitet dëshmia e një ose më shumë dëshmitarëve.

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit përcaktohet edhe në legjislacionin penal bashkëkohor e cila i jep rëndësi të veçantë kësaj prove gjatë procesit të të provuarit.

Gjithashtu kjo vërtetohet edhe në intervistat e realizuara me Gjykatës dhe Prokuror në Gjykatën Themelore në Strugë si dhe në Prokurorinë Publike në Strugë, ku të intervistuarit e konsideronin dëshminë e dëshmitarit si provë shumë të rëndësishme në aspektin praktik e cila duhet që të analizohet dhe konfirmohet me kujdes të veçantë sepse jo çdoherë mund të vijmë deri tek dëshmia e drejtë dhe e saktë, pasiqë në disa raste dëshmia mund të jetë jo e saktë, ku praktika sipas tyre njihet edhe raste të tilla.

Gjithashtu, në aspektin praktik ato konfirmuan se ka pasur raste kur nuk ka pasur prova të tjera përveç dëshmisë së dëshmitarit dhe me çrast dëshmia e dëshmitarit është konsideruar si mbretëreshë e provave në atë rast konkret.

Pra, nga e gjithë kjo mund të konstatojmë se dëshmia e dëshmitarit në procedurë penale është e një rëndësie të veçantë e cila mund ta konfirmojë edhe vendimin e çështjes penale konkrete për këtë arsye edhe Gjykatësit kësaj prove i japin rëndësi të veçantë.

4. PËRFUNDIM

Ky punim shkencor është i një rëndësie të veçantë për arsye se një fenomen shumë i rëndësishëm në procedurë penale siç është dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale është analizuar duke u bazuar në literaturën juridike të vendit, por ajo që është e veçantë është se është analizuar edhe në aspektin praktik e cila më së përafërti na jep pasqyrë më të qartë rreth mbarëvajtjes së kësaj prove në procedurë penale.

Pra, nga ky punim në mënyrë të qartë konfirmohet rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale si dhe kujdesi i cili duhet ti përkushtohet marrjes së dëshmisë së dëshmitarit.

5. REKOMANDIME

Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale paraqet një lëmi shumë të gjërë e cila kërkon studim dhe analizim dhe vazhdueshëm në çdo kohë duke e bazuar në legjislacionin bashkëkohor penal. Duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj prove në procedurë penale si dhe shtrirjen e saj të gjërë në procedurë penale, është e nevojshme që

kjo temë ose kjo sferë të analizohet edhe në aspektë të tjera ose në këndvështrime të tjera të cilat do të plotësojnë ose do të rrumbullaksojnë këtë çështje në procedurë penale.

6. MIRËNJOHJE

Për të realizuar këtë punim shkencor, përveç materialeve të shfrytëzuara, të një rëndësie të veçantë janë edhe individët të cilët me ndihmën e tyre të ofruar, arrita në përfundimin e këtij punimi shkencor.

Fillimisht faleminderoj Drejtorin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës - Prof. Dr. Ylber Sela për ndihmën e ofruar si dhe për motivacionin e dhënë për të përfunduar me sukses këtë punim shkencor.

Gjithashtu faleminderoj edhe Gjykatësin nga Gjykata Themelore në Strugë dhe Prokurorin nga Prokuroria Publike në Struga të cilët na e bënë më të qartë rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit në procedurë penale.

Faleminderoj edhe mikun tim Dardan Eminin për ndihmën e ofruar në çështjen e përkthimit të pjesëve të caktuara nga gjuha Angleze.

REFERENCAT

Kalajdziev, G., Lazetic, G., Nedelkova, L., Denkovska, M., Trombeva, M., Vitlarov, T., Jankulovska, P., & Kadiev, D. (2018). Komentimi i Ligjit të Procedurës Penale, Shkup , neni 218.

Kambovski , V., & Zejneli, I. (2018). E Drejta Penale:pjesa e përgjithshme, UEJL Tetovë.

Ligji i Procedurës Penale,gazeta zyrtare e RMV nr 150,prej 18.11.2011 , neni 212

Ligji I procedurës penale,gazeta zyrtare e RMV-së,nr.150,prej 18.11.2018,neni 218 paragrafi (1).

Osmani, A. (2010). Kodi Penal i RMV-së, Shkup , neni 367 paragrafi (1).

Sahiti, E., & Zejneli, I. (2017) E Drejta e Procedurës Penale, UEJL Tetovë.

Sahiti, E., & Zejneli, I. (2017). E Drejta e Procedurës Penale ,Shkup , fq. 158.

Sahiti, E. (2007). Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë, fq. 70

Sahiti, E. (1993). Dëshmia e Dëshmitarit si Provë në Procedurë Penale, Prishtinë, fq 46.

<https://www.scribd.com/doc/300046866/Akademija-ZKP-Modul-3-Priracnik-Glavna-Rasprava>